

Përdorimi i të drejtave të njeriut si mjet mbrojtës



Krijuar në bashkëpunim:



Contents

2 Çfarë është “Ligji për të drejtat e njeriut” dhe si funksionon ai?

4 Cilat janë të drejtat në “Ligjin për të drejtat e njeriut”?

5 Të drejtat absolute dhe jo-absolute

6 Neni 3: E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues

7 Neni 8: E drejta për jetë private dhe familjare, shtëpi dhe korrespondencë

9 Neni 14: E drejta për të qenë i lirë nga diskriminimi

11 Të drejtat e njeriut në mbrojtje: Shkrimi i letrave

15 Të drejtat e njeriut në mbrojtje: Përshkallëzimi i përgjegjes suaj

17 Të drejtat e njeriut në mbrojtje: Mbajtja e shënimeve

Çfarë është “Ligji për të drejtat e njeriut” dhe si funksionon ai?

Ligji për të drejtat e njeriut

Të drejtat e njeriut janë libri i rregullave për mënyrën se si mund të presim të trajtohemi nga qeveria, duke përfshirë shërbimet publike dhe stafin e tyre. Të drejtat e njeriut janë më shumë se vlera, respektimi i të drejtave të njeriut është ligj. Në Mbretërinë e Bashkuar ky ligj quhet “Ligji për të drejtat e njeriut”. Mund të gjeni më shumë informacion mbi “Ligjin për të drejtat e njeriut” [këtu](#).

Të kërkosh që të respektohen të drejtat e njeriut nuk do të thotë të kërkosh trajtim të veçantë, por thjesht të kërkosh respektimin e ligjit.

Kush ka të drejta sipas “Ligjit për të drejtat e njeriut”?

Të gjithë ata që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar kanë të drejta të njeriut. Ato janë “universale” që do të thotë se u përkasin të gjithëve – pavarësisht se kush jeni. Nuk ka rëndësi se ku keni lindur; nëse ndodheni në Mbretërinë e Bashkuar, të drejtat tuaja të njeriut mbrohen me “Ligjin për të drejtat e njeriut”. Nuk ka rëndësi se cili është statusi juaj i imigracionit.

Kur mund ta përdorim “Ligjin për të drejtat e njeriut”?

“Ligji për të drejtat e njeriut” zbatohet për autoritetet publike dhe për organet që kryejnë një funksion publik. Kjo do të thotë që nëse një kompani private kryen një funksion publik, ata kanë detyrime sipas “Ligjit për të drejtat e njeriut”. Ai zbatohet për personelin që punon në të gjitha nivelet e këtyre organeve.

Paragrafi 6 i “Ligjit për të drejtat e njeriut” cakton një detyrim ligjor për të gjitha autoritetet publike dhe personelin që punon në to. Ata duhet të veprojnë në përputhje me të drejtat e njeriut, në të gjithë punën e tyre çdo ditë. Kjo do të thotë se “Ligji për të drejtat e njeriut” u cakton një detyrim ligjor autoriteteve publike për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e njeriut në veprimet, vendimet, politikat dhe shërbimet e tyre.

Detyrimi për organet publike

Detyrimi për të respektuar do të thotë që autoritetet publike nuk duhet t'jua heqin të drejtat tuaja, megjithëse disa të drejta mund të kufizohen. Detyrimi për të mbrojtur njihet gjithashtu si mbrojtje. Kjo do të thotë se autoritetet publike duhet të ndërhyjnë për t'ju mbrojtur nëse e dinë se të drejtat tuaja janë në rrezik. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të hetojë nëse ka pasur ndonjë problem me të drejtat tuaja të njeriut.

Paragrafi 3 i “Ligjit për të drejtat e njeriut” thotë se i gjithë personeli që punon në autoritetet publike duhet të zbatojë të gjitha ligjet, politikat dhe udhëzimet, në një mënyrë që i respekton të drejtat e njeriut (për aq sa është e mundur).

Këto detyrime janë vërtet të rëndësishme në situatat e përditshme, sepse kjo do të thotë se ju mund që:



Të ngrini zërin sepse të gjithë kanë të drejta të njeriut.



Të bisedoni me shërbimet nëse ata po e përmbushin detyrimin e tyre ligjor për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut.



Të punoni me shërbimet për të gjetur zgjidhje më të mira pa pasur nevojë të shkoni në gjykatë ose të përdorni një avokat.



Ne mund ta përdorim “Ligjin për të drejtat e njeriut” sa herë që ndërveprojmë me shërbimet publike ose shërbimet që kryejnë një funksion publik. Për shembull, në letrat drejtuar Home Office, NHS, autoriteteve lokale ose kur kundërshtoni vendimin e një shërbimi publik.

Cilat janë të drejtat në “Ligjin për të drejtat e njeriut”?

“Ligji për të drejtat e njeriut” ka 16 të drejta. Disa nga këto të drejta janë ato që ne i quajmë të drejta absolute; kjo do të thotë se ato asnjëherë nuk mund të kufizohen ligjërisht. Të tjerat janë jo-absolute; kjo do të thotë se ekzistojnë rrethana të caktuara në të cilat një zyrtari publik mund t’i lejohe të kufizojë të drejtat e njeriut të një personi. Këto situata janë specifike dhe zakonisht duhet të ndjekin kriteret e ligjshme, legjitime dhe proporcionale:



I ligjshëm: ekziston një ligj që i lejon zyrtarët publikë ta ndërmarrin atë veprim ose vendim.



Legjitim: ekziston një arsye e fortë (për shembull siguria publike ose mbrojtja e të drejtave të njerëzve të tjerë).



Proporcional: ata kanë menduar për gjëra të tjera që mund të bëjnë, por nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të mbrojtur personin në fjalë apo njerëzit e tjerë. Duhet të jetë opsioni më pak kufizues.

Nëse një zyrtar apo organ publik nuk mund t’i përmbushë këto 3 kritere, atëherë kufizimi i të drejtave të njeriut që ata duan të vendosin nuk do të jetë i ligjshëm.

Mund të gjeni më shumë informacion për secilën nga 16 të drejtat [këtu](#).

Të drejtat Absolute dhe Jo-Absolute

Absolute

E drejta për jetën (Neni 2)

E drejta për të qenë i lirë nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues (Neni 3)

E drejta për të qenë i lirë nga skllavëria dhe puna e detyruar (Neni 4)

E drejta për një gjykim të drejtë (Neni 6)

E drejta për të mos u ndëshkuar për diçka që nuk ishte në kundërshtim me ligjin kur e keni kryer (Neni 7)

E drejta për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe bindjeve fetare (Neni 9)

E drejta për arsim (Protokolli 1, Neni 2)

Heqja e dënimit me vdekje (Protokolli 13, Neni 1)

Jo-Absolute

E drejta për liri (Neni 5)

E drejta për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe bindjeve fetare (Neni 9)

E drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit (Neni 11)

E drejta për të mos u diskriminuar (Neni 14)

E drejta për arsim (Protokolli 1, Neni 2)

E drejta për jetë private dhe familjare, shtëpi dhe korrespondencë (Neni 8)

E drejta për lirinë e shprehjes (Neni 10)

E drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje (Neni 12)

E drejta për të gëzuar në paqe pasurinë (Protokolli 1, Neni 1)

E drejta për zgjedhje të lira (Protokolli 1, Neni 3)

*Disa të drejta janë edhe absolute edhe jo-absolute. Kjo do të thotë se ato përmbajnë një pjesë që nuk mund të kufizohet asnjëherë, por ato gjithashtu përmbajnë një pjesë që mund të kufizohet në rrethana të kufizuara.

Neni 3: E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës

E drejta për të qenë i lirë nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës sipas Nenit 3 i mbron njerëzit nga trajtimi në një mënyrë që u shkakton atyre dëmtime serioze mendore ose fizike ose i poshtëron ata. Ky është një trajtim i cili:



ju bën shumë të frikësuar ose të shqetësuar



ju shkakton shumë dhimbje



ju bën të ndiheni i pavlerë ose pa shpresë

Për të përdorur “Ligjin për të drejtat e njeriut” për t’ju mbrojtur kundër trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, trajtimi duhet të jetë shumë serioz.

Kjo e drejtë është absolute. Kjo do të thotë se nuk është kurrë e ligjshme që dikush të trajtohet në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruëse nga një autoritet publik (ose organ që kryen një “funksion publik”) – qoftë i qëllimshëm apo jo.

Studim rasti: Historia e Lolës

Lola ishte një grua shtatzënë të cilës sapo i ishte refuzuar azili. Ajo jetonte në strehim të siguar nga qeveria dhe iu dha një njoftim për “përfundimin e ndihmës” ndërsa po lindte në spital. Ajo ishte një prind i vetëm dhe ky ishte fëmija i saj i dytë.

Periodha e njoftimit skadoi ndërsa ajo ishte ende në spital dhe kur të kthehej në shtëpi, ajo dhe fëmijët e saj do të duhej të largoheshin nga banesa e tyre. Lola mori mbështetje nga një organizatë bamirëse lokale e cila i tha ofruesit të strehimit se dëbimi i familjes në këto rrethana mund të shkelte të drejtën e tyre për të mos u trajtuar në një mënyrë çnjerëzore dhe degraduese (Neni 3). Organizata bamirëse i shkroi ofruesit të strehimit duke shpjeguar detyrën e tyre sipas “Ligjit për të drejtat e njeriut” dhe duke kërkuar që periodha e njoftimit të zgjatej për t’i dhënë Lolës më shumë kohë për të gjetur strehim të përshtatshëm.






Ofruesi vendosi të ndryshojë statusin e njoftimit, duke i dhënë Lolës dhe organizatës bamirësisë kohë për të aplikuar për ndihmë për familjen (Seksioni 4). Aplikimi ishte i suksesshëm dhe u siguroa strehim për familjen.

Mund të mësoni më shumë për këtë këtu.



Neni 8: E drejta për jetë private dhe familjare, shtëpi dhe korrespondencë

E drejta për jetë private dhe familjare, shtëpi dhe korrespondencë mbrohet nga Neni 8 i "Ligjit për të drejtat e njeriut". Secila pjesë e kësaj të drejte mbron shumë gjëra të ndryshme.


E drejta për jetën private mbron:

-  mirëqenien (shëndetin mendor ose fizik)
-  autonominë (përfshirjen e njerëzve në vendimet mbi trupin dhe jetën e tyre)
-  pjesëmarrjen në komunitet
-  marrëdhëniet me të tjerët
-  konfidencialitetin



E drejta për jetë familjare mbron:

-  zhvillimin e marrëdhënieve të zakonshme familjare
-  kontaktin e vazhdueshëm nëse janë të ndarë

E drejta për shtëpi mbron:

-  gëzimin e shtëpisë suaj aktuale. Kjo nuk është një e drejtë për strehim, por mbron gëzimin e shtëpisë që keni aktualisht. Për shembull, kjo e drejtë mbron kundër hyrjes së policisë ose një shërbimi tjetër publik në shtëpinë tuaj pa lejen tuaj.

E drejta për korrespondencë mbron:

-  pasjen e komunikimit të pacensuruar me të tjerët
-  letrat dhe komunikimet moderne (SMS, email, telefonata)

Kjo e drejtë është jo-absolute, që do të thotë se çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të plotësojë kriterin e ligjshëm, legjitim dhe proporcional.



I ligjshëm: ekziston një ligj që i lejon zyrtarët publikë ta ndërmarrin atë veprim ose vendim.



Legjitim: ekziston një arsye e fortë (për shembull siguria publike ose mbrojtja e të drejtave të njerëzve të tjerë).



Proporcional: ata kanë menduar për gjëra të tjera që mund të bëjnë, por nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të mbrojtur personin në fjalë apo njerëzit e tjerë. Duhet të jetë opsioni më pak kufizues.



Studim rasti: Historia e Homas

Homa jetonte në Londrën e Jugut. Pasi ishte larguar për në Mbretërinë e Bashkuar pas persekutimit në vendin e tij, ai ishte në procesin e kërkimit të azilit. Dëmtimi nga i cili u largua Homa e la atë me çrregullim të stresit post-traumatik dhe për të shkuar në takimet e tij mjekësore dhe shërbimet e tjera mbështetëse, i duhej të udhëtonte në Londrën Veriore. Homa ishte shumë i shqetësuar për kërkesën e tij për azil në pritje dhe mundësinë që ai të mund të dëbohej për në vendin e tij, ku do të përballlej me persekutim dhe keqtrajtim.

Për shkak të çrregullimit të stresit post-traumatik, Homa përjetonte sulme paniku sa herë që ishte në autobus për më shumë se 10 minuta. Atij i duhej të zbriste nga autobusi, të qetësohej dhe më pas të priste autobusin tjetër. Ndonjëherë i duheshin disa orë për të arritur atje për ku ishte nisur dhe përdorte pjesën më të madhe të fondeve të kufizuara që i ishin dhënë sepse shpesh i duhej të paguante për disa udhëtime me autobus. Punonjësja e çështjes së Homas, Lin, e kuptoi se udhëtimi i gjatë, së bashku me gjendjen e tij ekzistuese të shëndetit mendor, kishte një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e tij.

Lin i shkroi bashkisë lokale që ishte përgjegjëse për sigurimin e kartave të autobusëve për njerëzit në nevojë të veçantë dhe ngriti të drejtën e Homas për respektimin e jetës private (Neni 8) dhe konkretisht se si kjo mbron të drejtën e njerëzve për integritet psikologjik. Bashkia lokale ra dakord se ndikimi ekstrem i situatës në mirëqenien e Homas po ndërhynte në të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe se ata kishin detyrimin të ndërmerren veprime proporcionale për të reduktuar këtë ndikim. Homa iu dha një abone autobusi në mënyrë që të mund të udhëtonte në takimet e tij sipas mënyrës së tij të udhëtimit dhe të merrte trajtimin që i nevojitej.

Mund të mësoni më shumë për këtë këtu.

Neni 14: E drejta për të qenë i lirë nga diskriminimi

Kjo nuk është një e drejtë më vete për të qenë i lirë nga diskriminimi. Është e drejtë për të mos u diskriminuar kur mbështeteni në të drejtat tuaja të tjera në “Ligjin për të drejtat e njeriut”. E drejta për të qenë i lirë nga diskriminimi ndonjëherë quhet e drejtë “e mbartshme”. Kjo do të thotë që kur një nga të drejtat tuaja të tjera është në rrezik, ju mund të ngrini edhe të drejtën tuaj për mosdiskriminim nëse mendoni se është problem.



“Ligji për të drejtat e njeriut” dhe “Ligji i barazisë”

“Ligji për të drejtat e njeriut”, ndryshe nga ligjet e tjera të diskriminimit, si “Ligji i barazisë”, është i pakufizuar. Kjo do të thotë se ai mund të zbatohet për një gamë më të gjerë rrethanash sesa ligjet e tjera. “Ligji i barazisë” ndalon diskriminimin vetëm për 9 arsye, të quajtura karakteristika të mbrojtura. Këto janë: moshë, aftësia e kufizuar, ndryshimi i gjinisë, martesë dhe partneriteti civil, shtatzënia dhe amësia, raca, feja ose besimi, seksi dhe orientimi seksual.

“Ligji për të drejtat e njeriut” e bën të paligjshëm diskriminimin kundër jush, duke përcaktuar një listë arsyesh që përfshijnë seksin, racën, ngjyrën, gjuhën, fenë, opinionet politike ose të tjera, origjinën kombëtare ose shoqërore, përkatësinë në një pakicë kombëtare, pronën ose lindjen. Është e pakufizuar sepse më pas thotë “ose status tjetër”, ku gjykatat kanë vendosur se përfshin moshën, identitetin gjinor, orientimin seksual, shëndetin dhe aftësinë e kufizuar, statusin prindëror dhe martesor dhe statusin e emigracionit. Kjo mund të përfshijë edhe përjetimin e diskriminimit për arsye të kombinuara – të tilla si të qenit një person i ri, zezak, me aftësi të kufizuara. “Ligji për të drejtat e njeriut” u cakton një detyrim ligjor organeve publike që të respektojnë dhe mbrojnë këtë të drejtë, ndërsa “Ligji i barazisë” zbatohet për organet publike dhe private, duke përfshirë dyqanet dhe restorantet.

Kjo e drejtë do të thotë që kur përdorni “Ligjin për të drejtat e njeriut”, duhet të trajtoheni njësoj si të gjithë të tjerët. Kjo do të thotë:



të mos trajtoheni më keq se njerëzit e tjerë në të njëjtën situatë për shkak të racës, moshës, fesë, identitetit gjinor, statusit të emigracionit etj.



të mos trajtoheni ndryshe kur jeni në një situatë shumë të ndryshme nga të tjerët, për shembull të mos ju jepet një përkthyes kur ju nevojitet vërtet.

Studim rasti: Historia e Selinës

Selina jetonte në Essex dhe mori statusin e refugjatit. Asaj iu desh të shkonte në spital për disa javë.

Selina kishte pak kohë që mësonte anglisht, por ende nuk ishte shumë komode që të përdorte anglishten, veçanërisht me mjekët që përdornin terma të ndërlikuara mjekësore. Erdhi një mjek për t’i dhënë asaj rezultatet e disa analizave që kishte bërë. Selina nuk e kuptoi mirë atë që ai i tha. Ajo kërkoi përkthyes, por iu tha se anglishtja e saj ishte mjaft e mirë dhe nuk kishte nevojë për një të tillë.

Një shoqe e Selinës i erdhi asaj për vizitë në spital dhe i tha se ajo mund të përdorë të drejtat e saj të njeriut. Ato i thanë stafit të spitalit se kjo po prekte të drejtën e Selinës për mirëqenie dhe autonomi (pjesë e së drejtës për jetën private dhe familjare), pasi ajo nuk mund ta kuptonte mirë dhe të fliste siç duhej për trajtimin e saj pa një përkthyes, dhe se ky ishte diskriminim. Stafi deklaroi se ata po ndiqnin politikën e spitalit, e cila thoshte se ata duhet të përdorin përkthyes vetëm nëse është absolutisht e nevojshme, sepse kjo i kushton spitalit shumë para.

Shoqja e Selinës e ndihmoi atë t’i shkruante një letër Shërbimit të Këshillimit dhe Ndërlidhjes me Pacientët të spitalit duke shpjeguar se kjo politikë nuk përmbushte detyrimin e spitalit sipas Nenit 8 të “Ligjit për të drejtat e njeriut” dhe mund të rezultonte që njerëzit me anglishten si gjuhë të dytë të diskriminoheshin në mënyrë të padrejtë sipas Nenit 14.

Spitali ra dakord dhe e ndryshoi politikën e vet në mënyrë që të ofrohet gjithmonë përkthyes për njerëzit që nuk e kanë anglishten gjuhë të parë.

Mund të mësoni më shumë për këtë këtu.

Të drejtat e njeriut në mbrojtje: Shkrimi i letrave

INëse e keni ngritur një çështje duke përdorur gjuhën e të drejtave të njeriut pranë autoritetit publik përkatës dhe nuk jeni në gjendje ta zgjidhni çështjen në mënyrë jozyrtare, mund të mendoni të shkruani një letër.

Kjo ka shumë përparësi, veçanërisht pasi organizata duhet t'ju shkruajë një letër si përgjigje. Letra ju jep juve një mënyrë për të shpjeguar situatën, për të identifikuar rezultatin e dëshiruar dhe për të mbajtur një arkiv të situatës.

Këshilla për të shkruar një letër



Paraqitni faktet. Ju duhet të jepni detaje të mjaftueshme për të shpjeguar situatën, por jo aq shumë sa t'i bëni konfuzë njerëzit të cilëve po u shkruani. Mundohuni ta përmbledhni atë në jo më shumë se 1 faqe.



Tregohuni specifik se cilat të drejta nuk po jua mbrojnë apo respektojnë. Tregojuni atyre pse mendoni kështu.



Shpjegoni se çfarë mendoni se duhej të kishin bërë ata dhe çfarë mendoni se duhet të bëjnë tani.



Tregohuni i qartë, i sjellshëm dhe tregoni se prisni një përgjigje.



Jepjani letrën dikujt tjetër ta lexojë për t'u siguruar që ka kuptim për dikë që nuk e njeh rastin tuaj.

1) Shembull i një letre nga një individ

Emri juaj
25 Rruga e Re
L17UX
Emaili/numri i kontaktit

E nderuara Znj. Bloggs,

Shpjegoni se kush jeni dhe lidhjen tuaj me bashkinë në mënyrë që ata të dinë pse po u shkruani.

Më quajnë Znj. X dhe jetoj në adresën 25 Rruga e Re, L17UX, një pronë e autoritetit lokal. Po shkruaj në lidhje me problemin e vazhdueshëm me ndriçimin jashtë derës së banesës sime. Ndriçimi është prishur prej 3 muajsh, që do të thotë se më duhet të eci në rrugicën deri te dera ime dhe ta hap derën në errësi. Kjo më ka shkaktuar shqetësime të konsiderueshme dhe kam frikë të largohem ose të kthehem në shtëpinë time pasi erret. Kjo ka një ndikim të madh në jetën time, veçanërisht gjatë muajve të dimrit. Unë e kam ngritur këtë çështje shumë herë me punonjës të strehimit dhe kam treguar ndikimin që kjo ka në shëndetin tim mendor, duke përfshirë shkaktimin e sulmeve të panikut. Unë kam shpjeguar gjithashtu se ndikimi ka qenë veçanërisht i thellë pasi jam një e mbijetuar e torturës. Megjithatë, ndriçimi ende nuk është rregulluar.

Shpjegoni historikun dhe çfarë ka ndodhur. Shpjegoni ndikimin që ka te ju.

Si një departament strehimi i autoriteteve lokale, ju keni një detyrim ligjor sipas "Ligjit për të drejtat e njeriut" për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e mia. Meqenëse problemi me ndriçimin ka vazhduar prej disa muajsh dhe ka një ndikim të rëndësishëm në shëndetin tim mendor, duke përfshirë edhe sulmet e panikut, kjo mund të arrijë nivelin e trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues (Neni 3 në "Ligjin për të drejtat e njeriut"), veçanërisht duke pasur parasysh që jam një e mbijetuar e torturës. Mungesa e veprimtimit për këtë çështje po ndërhyr në mirëqenien time fizike dhe mendore, e cila mbrohet nga e drejta ime për respektimin e jetës private dhe familjare (Neni 8). Unë kam bashkangjitur një letër nga këshilltari im, Dr. Jacobs, që shpjegon ndikimin në shëndetin tim mendor.

Shpjegoni se ata kanë një detyrim sipas "Ligjit për të drejtat e njeriut".

Shpjegoni se cilat të drejta mendoni se janë prekur dhe pse. Fillimisht fokusohuni te të drejtat absolute, pastaj tek ato jo-absolute. Ju mund të shtoni detaje personale që ndiheni komod t'i zbuloni për të treguar ndikimin që kjo ka veçanërisht te ju. Kjo për shembull mund të ketë të bëjë me shëndetin tuaj mendor, përvojat tuaja të mëparshme ose situatën tuaj familjare. Ju gjithashtu mund të ofroni çdo provë që keni që mbështet rastin tuaj, të tilla si letra nga mjekët ose punonjësit mbështetës.

"Ligji për të drejtat e njeriut" nënkupton se çfarëdo kufizimi i një të drejte absolute, siç është e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues, nuk është kurrë i ligjshëm. Prandaj, duhet të merren masa të menjëhershme për të rregulluar ndriçimin, për t'u siguruar që të ndihem e sigurt kur kthehem në shtëpi dhe të mos jem më në rrezik nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues. Çdo kufizim i një të drejte jo-absolute siç është e drejta për mirëqenie në jetën private dhe familjare, duhet të jetë i ligjshëm, legjitim dhe proporcional. Unë nuk besoj se vendimi për të mos rregulluar ndriçimin jashtë shtëpisë sime është i ligjshëm; nuk ekziston një arsye e fortë për kufizimin e kësaj të drejte, siç është siguria publike ose mbrojtja e të drejtave të njerëzve të tjerë. Duke pasur parasysh ndikimin që kjo situatë ka tek unë dhe te të drejtat e mia, nuk është gjithashtu proporcionale që unë të pres më shumë se 3 muaj që të rregullohet ndriçimi. Prandaj do të kërkoja që urgjentisht të rregullohet ndriçimi jashtë shtëpisë sime.

Shpjegoni se çfarë dëshironi të bëni për ta zgjidhur këtë çështje.

Do t'ju isha mirënjohëse nëse mund t'i përgjigjeshit letrës sime brenda dy javëve nga data më lart, jam e sigurt se këtë çështje mund ta zgjidhim në mënyrë miqësore.

Me nderime,
Emri juaj

Caktoni një kornizë kohore të përshtatshme për hapat e ardhshëm.

2) Shembull i një letre/ emaili nga një individ

Emri juaj
25 Rruga e Re
L17UX
Emaili/numri i kontaktit

E nderuara Znj. Smith,



Shpjegoni se kush jeni dhe lidhjen tuaj me ekipin e strehimit në mënyrë që ata të dinë pse po u shkruani.

Më quajnë Znj. Y dhe jetoj në një banesë për azilantë në adresën 25 Emri i Rrugës, L17UX. Po shkruaj në lidhje me një letër që kam marrë së fundi, ku thuhet se do të transferohem më 17 mars 2022 dhe se adresa ime e re mund të jetë kudo në vend. Kjo më ka shkaktuar një shqetësim të madh. Unë kam jetuar në qytetin tim aktual për 2 vjet, pasi kam ardhur në Mbretërinë e Bashkuar si azilkërkuese duke ikur nga persekutimi në bazë të orientimit tim seksual. Unë kam ndërtuar një rrjet të gjerë mbështetjeje këtu që është thelbësor për mirëqenien time mendore dhe emocionale, duke përfshirë të qenit një anëtare aktive e një grupi lokal mbështetës LGBT. Gjithashtu po marr kujdes mjekësor të specializuar që do të ndërpritej nëse largohem nga zona.



Shpjegoni historikun dhe çfarë ka ndodhur. Shpjegoni ndikimin që ka te ju.

Unë e kuptoj se politika juaj është që akomodimi në përgjithësi ofrohet pa zgjedhje, përveç rasteve kur ka rrethana të jashtëzakonshme. Politika e caktimit të akomodimit nga Home Office kërkon që ju të merrni parasysh çdo kërkesë sipas rastit dhe, "nëse vendoset të mos bihet dakord për të ofruar akomodim në një vendndodhje të caktuar, duhet të jepen arsytet dhe vendimi duhet të jetë në përputhje me detyrimet e Home Office sipas legjislacionit për të drejtat e njeriut" (fq.5).

Aty ku është e mundur, referojuni politikave ose ligjeve që mbështesin rastin tuaj. Vini në dukje se ligjet duhet të interpretohen në mënyra të cilat mbështesin të drejtat e njeriut sa herë që është e mundur.

Si një ofrues strehimi i kontraktuar nga Home Office, ju duhet të respektoni detyrimin ligjor sipas "Ligjit për të drejtat e njeriut" për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e mia.

Shpjegoni se ata kanë një detyrim sipas "Ligjit për të drejtat e njeriut". Edhe pse Shoqata e Strehimit mund të jetë një kompani private, vazhdon të zbatohet detyrimi i "Ligjit për të drejtat e njeriut" sepse ato janë të kontraktuara nga Home Office (një organ publik).

Ndërprerja e kujdesit tim mjekësor do të kishte një ndikim të rëndësishëm në shëndetin tim fizik dhe mendor, i cili mund të arrijë nivelin e trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës (të ndaluar nga Neni 3 i "Ligjit për të drejtat e njeriut"), veçanërisht kur marrim parasysh natyrën e veçantë të kujdesit tim. Mirëqenia ime fizike, mendore dhe emocionale mbrohet gjithashtu nga e drejta ime për jetën private dhe familjare (Neni 8). Largimi nga sistemi im i mbështetjes dhe grupi im i komunitetit LGBT, do të ndërhyjë në të drejtën time për jetën private, veçanërisht pasi më parë jam përballur me persekutime për shkak të orientimit tim seksual. Unë kam bashkangjitur një letër nga drejtuesi i grupit të komunitetit që shpjegon mbështetjen që më kanë dhënë.

Shpjegoni se cilat të drejta mendoni se janë prekur dhe pse. Fillimisht fokusohuni te të drejtat absolute, pastaj tek ato jo-absolute. Ju mund të shtoni detaje personale që ndiheni komod t'i zbuloni për të treguar ndikimin që kjo ka veçanërisht te ju. Kjo për shembull mund të ketë të bëjë me shëndetin tuaj mendor, përvojat tuaja të mëparshme ose situatën tuaj familjare. Ju gjithashtu mund të ofroni çdo provë që keni që mbështet rastin tuaj, të tilla si letra nga mjekët ose punonjësit mbështetës.

"Ligji për të drejtat e njeriut" nënkupton se çfarëdo kufizimi i një të drejte absolute, siç është e drejta për të qenë i lirë nga trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës, nuk është kurrë i ligjshëm. Prandaj, nuk duhet të transferohem në një zonë të re ku kjo do të më ndërpresë ose do të pengojë marrjen e kujdesit të duhur mjekësor. Çdo kufizim i një të drejte jo-absolute siç është e drejta për jetën private dhe familjare, duhet të jetë i ligjshëm, legjitim dhe proporcional. Nuk besoj se vendimi për të më transferuar nga zona ime aktuale është legjitim, pasi nuk ka asnjë arsye bindëse për të më transferuar. Unë gjithashtu nuk besoj se është proporcional, pasi nuk keni treguar se keni shqyrtuar opsionet alternative. Prandaj, do të kërkoja që planet për transferimin tim të anulohen urgjentisht.

Duke qenë se transferimi është planifikuar së shpejti, do të isha mirënjohës nëse mund t'i përgjigjeni letrës sime deri në orën 16:00 të datës 15 mars 2022.

Me nderime,
Emri juaj.



Caktoni një kornizë kohore të përshtatshme për hapat e ardhshëm.

Shpjegoni se çfarë dëshironi të bëni për ta zgjidhur këtë çështje.



Çfarë duhet të bëni më pas nëse nuk merrni një përgjigje

Nëse përgjigjja është e dobishme dhe autoriteti publik dëshiron të diskutojë me ju se si të ndihmojnë në zgjidhjen e situatës, atëherë kërkonit të takoheni me ta dhe ta diskutoni më tej çështjen. Ky takim nuk duhet domosdoshmërisht të jetë personalisht, mund të jetë edhe përmes një telefonate:

- ✓ *Mos harroni të mbani shënime të hollësishme të takimeve, duke përfshirë gjithçka që ata thonë se do të bëjnë.*
- ✓ *Kërkonit një afat kohor dhe bëni një shënim për këtë.*
- ✓ *Nëse ata nuk arrijnë të bëjnë korrigjimet që keni kërkuar; ose nëse nuk e bëjnë këtë brenda afatit kohor të rënë dakord, kërkonit të takoheni përsëri me ta. Tregojuni atyre se do ta përshkallëzoni ankesën tuaj nëse ajo nuk adresohet shpejt.*
- ✓ *Nëse nuk jeni i kënaqur dhe ata refuzojnë ta marrin seriozisht ankesën tuaj ose vazhdojnë të shpërfillin të drejtat tuaja, atëherë duhet të bëni një kërkesë tjetër, duke përmendur datën dhe përmbajtjen e kërkesës origjinale.*

Çfarë duhet të bëni më pas nëse nuk merrni një përgjigje

Në varësi të seriozitetit dhe urgjencës së problemit tuaj, nëse nuk merrni përgjigje brenda një periudhe të arsyeshme kohore, duhet ta ndiqni letrën tuaj me një telefonatë për të kontrolluar nëse ajo është marrë.



A Nëse letra nuk është marrë:

- *Ridërgojeni atë dhe bëni një kërkesë këmbëngulëse për një përgjigje brenda një periudhe të caktuar kohore.*
- *Tregojuni atyre se dëshironi që t'ju njoftojnë për marrjen sapo të arrijë letra*



B Nëse letra është marrë, por individi në fjalë është i paqartë se kur prisni të merrni përgjigje, ose nuk duket se e merr seriozisht çështjen:

- *Ridërgojuni një kopje të letrës suaj drejtuesve të autoritetit publik (për shembull shefit ekzekutiv ose drejtuesit të një shërbimi brenda një këshilli).*
- *Tregohuni specifik në lidhje me letrën tuaj të mëparshme dhe përfshini datën kur është dërguar dhe kujt i është drejtuar.*
- *Tregojini menaxherit / shefit ekzekutiv / shefit të shërbimit se nuk keni marrë asnjë përgjigje për letrën tuaj të parë.*
- *Ju gjithashtu mund t'i dërgoni një letër tjetër personit që ka marrë letrën e parë për t'i treguar për veprimin që keni marrë. Kjo mund t'i inkurajojë ata të veprojnë më shpejt.*

Të drejtat e njeriut në mbrojtje: Përshkallëzimi i përgjigjes suaj

Përshkallëzimi i ndërhyrjes suaj mund të marrë disa forma:



Të forconi argumentet për të drejtat e njeriut në një letër vijuese.



Të kërkon një takim të menjëhershëm për të diskutuar përgjigjen.



Të paralajmëroni ata se ju do të detyroheni të ndërmerri veprime më serioze nëse çështja nuk zgjidhet.



T'i shkruani direkt menaxhimit të nivelit më të lartë.



Nëse nuk merrni përgjigje dhe jeni ankuar tek autoritetet publike pa u zgjidhur situata, mund të shkoni tek ombudsmani (avokati i popullit). Ky është një person i pavarur që mund ta shqyrtojë situatën tuaj. Ka ombudsmanë të ndryshëm në varësi të shërbimit për të cilin ankoheni. Mund të lexoni më shumë për ombudsmanët këtu.



Nëse situata nuk zgjidhet, mund t'ju duhet të kërkon këshillë ligjore. Disa këshilla ligjore mund të ofrohen falas. Këtu mund të mësoni nëse keni të drejtë për këshilla ligjore falas.



·Një avokat mund t'ju ndihmojë të shkruani një letër protokollit para ndërmarrjes së veprimit. Kjo bëhet për të ndihmuar në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje përpara se të fillojnë procedurat gjyqësore. Zakonisht, nëse nuk merret përgjigje brenda një kohe të caktuar, do të fillojnë procedurat gjyqësore. Prandaj, është e dobishme të merrni këshilla ligjore përpara se të dërgoni letrën e protokollit para ndërmarrjes së veprimit, në rast se duhet të shkojë në gjykatë.

Mënyra e veprimit që do të merrni ndoshta do të varet nga urgjenca e rastit dhe nëse jeni në ankth të mos armiqësoheni me shkollën / autoritetin lokal / spitalin ose organin tjetër ku ka lindur shqetësimi. Nëse besoni se një mënyrë veprimi relativisht jokonfrontuese mund të çojë në zgjidhje dhe autoriteti publik duket se po bën përpjekje për t'iu përgjigjur shqetësimeve tuaja, mund t'ia vlejë të kërkon një takim (të mëtejshëm) për të biseduar drejtpërdrejt me individët.

Kërkesa për një shpjegim të vendimit të tyre

Çdo letër ose takim vijues duhet gjithashtu t'i kërkojë autoritetit të shpjegojë se si ata arritën në vendimin që ka çuar në shqetësimin tuaj. Duke i pyetur ata për këtë, ju shpesh do t'i detyroni ata ta rishqyrtojnë çështjen në dritën e ligjit. Kjo shpesh mund t'i çojë ata drejt një përgjigjeje më të kënaqshme.

Është gjithashtu e dobishme të keni arsyetimin e tyre të plotë përpara se të ndërmerri veprime të mëtejshme, pasi e bën më të lehtë të kërkonin ndihmë nga grupet mbështetëse ose këshilltarët për të kundërshtuar vendimin.

Forcimi i argumenteve për të drejtat e njeriut

Jepni më shumë detaje

Përshkruani më në detaje pse mendoni se ka një problem me të drejtat e njeriut. Kjo ndoshta do të përfshijë përshkrimin më të detajuar të shkallës së vuajtjes nga ana e individit dhe referimin e përmbajtjes së artikujve përkatës.

Diskutoni proporcionalitetin

Autoriteti mund të pranojë se ka pasur disa kufizime të të drejtave të njeriut, por beson se mënyra e tyre e veprimit ishte një përgjigje proporcionale duke pasur parasysh kërkesat e tjera që ata duhet të plotësojnë.

Pyetini se si arritën në këtë vendim dhe përshkruani më hollësisht pse mendoni se ai nuk ishte proporcional – për shembull, duke sugjeruar një mënyrë tjetër veprimi ose duke përshkruar shkallën e vuajtjes së individit në fjalë.

Shkelja e të drejtave absolute

Nëse besoni se shkelja është aq serioze sa përbën trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës, ose një kërcënim për jetën, një përgjigje me "proporcionalitet" nuk do të jetë e kënaqshme. Tregojini autoritetit pse besoni se është shkelur një e drejtë absolute. Kujtoju atyre se të drejta të tilla nuk lejojnë asnjë përjashtim dhe autoriteti duhet të veprojë menjëherë për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm dhe për të korrigjuar situatën.

Created as part of the BIHR Co-Design A Human Rights Support Solution Project
Published July 2022



Ky burim është vetëm për efekt informimi. Ai nuk është hartuar dhe nuk duhet të përdoret si këshillë apo udhëzim ligjor. Ligji i përmendur në këtë burim mund të ketë ndryshuar që nga koha e publikimit.